Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**26.12.2023**	**09.01.2024**	**2023/0997**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.12.2023, OE "ROA Consulting SH.P.K."- Podujevë, ka parashtruar ankesë me numër: 2023/0997, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Te Samia"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pompa Denver dhe pjese te pompës ne Flotacion" me nr. të prokurimit: "12997 12998-23-11501-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Trepça SH.A. AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 90,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,

AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së - Informatat Sekrete Afariste,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës,

AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së – Përshtatshmëria e OE,

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së – Projektet e realizuar anë vlerë të kërkuar,

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë,

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

1. AK përkatësisht Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka shkelur nenin 7 të LPP-së gjatë procesit të ri vlerësimit të ofertave pasi ka shpërblyer me kontratës një OE i cili ka shumë mangësi në tenderin e tij me të cilat realisht është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm. Mos penalizimi i këtij OE për mangësitë që i posedon në tenderin e tij, përbën favorizim të hapur ndaj tij që njëkohësisht përbënë shkelje të plotë të nenit 7 të LPP-së. Ky veprim përpos tjerash përbën edhe shkelje të nenit 1 dhe 6 të LPP-së sepse sipas kësaj AK do të bëj shfrytëzim jo efikas, jo ekonomik dhe jo transparent të parasë publike pasi që AK tenton ta shpërblej me kontratë një OE që posedon çmimin për 3,551.80€ apo më shumë se 5% më të lartë se ne. Përpos çmimit neve na ka diskriminuar edhe kur na ka eliminuar sepse i plotësojmë të gjitha kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Të gjitha arsyetimet për anulimin tonë janë të pabazuara, tendencioze dhe plotësisht të jashtë ligjshme. Sqarimin dhe argumentimin detal e gjeni tek pika 3.

Këto veprime të AK-së përkatësisht të Komisionit të Vlerësimit bien plotësisht ndesh me nenin 1 dhe 6, e veçanërisht me nenin 7 të LPP-së. Si dispozita ligjore në asnjë formë nuk ia lejojnë AK-së dhe Komisionit të Vlerësimit të ndërmarrin ndonjë veprim i cili ndikon në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë jo efikase, jo ekonomike dhe jo transparente si dhe nuk ia lejojnë që të bëjnë as favorizim të OE të caktuar.

2. AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së pasi që edhe përkundër se ne kemi kërkuar që dokumentet e tenderit tonë të mbesin si sekret afarist, ky i fundit i ka dhënë qasje në dokumentet tona OE të interesuar duke mos ia ofruar ato vetëm pasi ta ketë përgatitur versionin e pastruar të dokumenteve. Pra mos respektimi i deklaratës tonë nga ana e AK-së e shtynë këtë të fundit drejt shkeljes së plotë të nenit 11 të LPP-së. (*deklaratën tonë e gjeni tek dokumentet e tenderit tonë*).

3. AK përkatësisht Komisioni i Vlerësimit ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk iu ka përmbajtur aspak dispozitave të këtij neni. Pika 4 e këtij neni e thotë shumë qartë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

E themi këtë sepse edhe përkundër që OE i shpallur fitues ka mangësi të theksuara në tenderin e tij, AK nuk i ka marrur fare për bazë dhe e ka shpërblyer. Ato një nga një do të i renditim në vazhdim.

Mangësia e parë: AK tek dosje e tenderit kishte kërkuar që OE i cili do përzgjidhet për fitues do të dorëzoj para Njoftimit mbi vendimin e AK-së edhe këto dëshmi:

Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para

dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.

OE TE SAMIA SH.P.K. nuk ka dorëzuar dëshminë mbi të shkuarën penale për kompaninë andaj si i tillë konsiderojmë se nuk e ka plotësuar kriterin dhe kushtin e kërkuar tek pika 6.4 e FDT-së. Pranimi i këtij OE si i përgjegjshëm përbën shkelje të plotë të nenit 65 të LPP-së nga të dyja palët dhe njëherit përbënë edhe shkeljet të nenit 59 të LPP-së pasi që nuk janë respektuar kërkesat e dosjes së tenderit.

Mangësia e dytë: AK tek pika 7.1&7.2 kishte kërkuar që Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e vet të themelimit. OE TE SAMIA SHPK e ka dorëzuar vetëm certifikatën e biznesit pa dëshmitë tjera për aktivitetet e që realisht konsiderohet mangësi e theksuar. Pa këto të dhëna nuk dihet se kush është pronar i kompanisë dhe sipas kontrollit në ARBK, i njëjti nuk e posedon aktivitetin adekuat të regjistruar për natyrën e shitjeve të produkteve për të cilat ka aplikuar në tender.

Mangësia e tretë: AK kishte kërkuar që OE të dorëzojnë katalogun me të dhëna teknike të sakta sipas kërkesave të paraqitura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ndërsa ky OE edhe pse i ka dorëzuar disa faqe të katalogut që sipas numrave rendor të faqeve duken të jenë të kombinuara vet, aty shihet se pompa e ofruar nuk i plotëson kërkesat e specifikimit teknik të AK-së për shumë elemente të pompave. Nga fotoja më poshtë shihet se dimensioni i boshtit të pompës së ofruar është 80 mm ndërsa kërkesa e AK-së tek aneksi 1 - specifikimi teknik ka qenë 85mm. Këto të dhëna shihen si të nënvizuara në tabelë. Nga kjo shihet se ky kusht nuk është plotësuar dhe se ky tenderues duhet të konsiderohet plotësisht i papërgjegjshëm. Shihi fotot e asaj që është ofruar dhe kërkesës së AK-së ku pas krahasimit vërehet mospërputhshmëri tek Diametri U, e që këtë OE e bënë të pa përgjegjshëm.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "**ROA Consulting SH.P.K.**", lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pompa Denver dhe pjesë të pompës në Flotacion"** me numër të prokurimit: **"12997 12998-23-11501-1-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Trepça SH.A.**



型号/Model	A	B	C	D	U	E	F	G	H	J	K	L	M	N	V	T	S	n-d	吐入口法兰 Suct		
																			D0	D1	D2
1.5/1B-AM	583	295	248	197	28	79	206	181	98	171	46	–	143	254	181	38	24	4-Φ14	152	38	114
1.5/1C-AMH	759	406	311	254	42	121	306	270	194	254	–	11	175	356	252	48	32	4-Φ19	152	38	114
2/1.5B-AM	592	295	248	197	28	79	217	205	114	184	33	–	143	254	184	38	24	4-Φ14	184	51	140
3/2C-AM	768	364	311	254	42	121	281	238	138	210	71	–	175	356	233	48	32	4-Φ19	216	76	178
3/2D-AMH	986	311	364	330	65	164	389	384	254	368	–	51	213	432	298	64	38	4-Φ22	216	76	178
4/3C-AM	84	406	211	254	42	121	354	292	149	262	24	–	175	356	270	48	32	4-Φ19	279	102	235
4/3D-AM	943	492	364	330	65	164	353	292	149	262	100	–	213	432	279	64	38	4-Φ22	279	102	235
4/3E-AMH	1240	622	448	457	80	222	492	492	330	432			257	546	381	76	54	4-Φ29	254	102	210
6/4D-AM	1021	492	364	330	65	164	421	406	229	338	11	–	213	432	318	64	38	4-Φ22	337	152	292
6/4E-AM	1178	622	448	457	80	222	433	406	229	338	138	–	257	546	351	76	54	4-Φ29	337	152	292
6/4F-AM	1556	857	635	610	108	279	584	616	411	546	–	–	349	762	280	98	95	4-Φ35	337	152	292
8/6E-AM	1302	622	448	457	80	222	557	551	318	460	–	62	257	546	402	76	54	4-Φ29	406	203	356
10/8ST-AM	1337	622	448	457	80	222	584	613	381	470	–	83	257	546	403	76	54	4-Φ29	502	254	445
10/8F-AM	1635	990	635	610	100	279	584	673	419	635	–	–	349	762	280	98	95	4-Φ35	502	254	445
12/10F-AM	1725	990	635	610	100	279	584	755	464	674	–	–	349	762	280	98	95	4-Φ35	527	305	470
14/12F-AM	1755	990	635	610	100	279	584	937	629	832	–	–	349	762	280	98	95	4-Φ35	585	356	521
16/14G-AM	2180	1208	876	850	140	356	953	1048	660	889	–	–	749	850	502	152	63	4-Φ41	705	406	641

Dimensionet nga prodhuesi për pompat me parametrat 10/8

U - diamteri i boshtit dhe nga AK eshte kerkuar te jete 85mm ndersa nga OE TE SAMIA SHPK eshte ofruar 80mm

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr.	Përshkrimi		Sasia	Njësia
1	Pompa centrifugale për lym 10x8" denver (ose ekujvalent) (HPZ 250/200) komplet me qark punues i gumuar me bazament, pulexha (1+1), rrypat dhe mbrojtëse të tyre. Elektromotori: nel=75kW, nrr.el.=1485rr/min, 380V, 50Hz, 136A Kapaciteti Q=258m^3/h Mundi: Y=395J/kg (H=40m); Pesha specifike e pulpës: 1200-1400t/m^3; Nr. rrot. PP=960rr/min; Pdalj=16bar; Diametri i boshtit të pernit të PP:Db=85mm; Diametri i qarkut punues të PP: Db=537mm; Diametri i jashtëm i cilindrit rr. Dc.j.=254mm; Diametri i brendshëm i cilindrit rr. Db.c.=190mm	Pjesët hargjuese janë të mveshura me gomë, komplet me electromotor të tipit të mbyllur	2	copë

Përpos kësaj siç shihet te fotoja e mësipërme (*Aneksi 1*), AK kishte kërkuar që diametri i brendshëm i cilindrit të jetë 190mm ndërsa OE TE SAMIJA SHPK ka ofertuar me pompë që e ka dimensionin e brendshëm 254mm. Ngjashëm edhe diametri i jashtëm i cilindrit është kërkuar te jete 254mm ndërsa OE TE SAMIJA, ka ofertuar me pompë që e ka dimensionin e jashtëm 203mm. Këtu shihet hapur se ky kusht nuk është plotësuar dhe se AK është dashur ta eliminoj si të papërgjegjshëm këtë OE. Shihe foton se me çfarë dimensionesh ka ofertuar OE TE SAMIA dhe krahasoje me kërkesën e AK-së ku do të bindeni me mos përputhshmërinë e vlerës së diametrave!

A M 型 渣 浆 泵
AM Slurry Pump

Pozita nr.1

型号 Type	流量 Capacity Q(m³/h)	扬程 Head H(m)	转速 Speed n (r/min)	必需汽蚀余量 NPSHr(m)	效率 Eff η(%)	轴功率 Shaft Power P(KW)	配用电机功率 Mating motor Power(KW)	口径 Dia. of pump (mm) 吸入 Inlet	口径 Dia. of pump (mm) 吐出 Outlet
10/8ST-AM	234	26.1	1350	2	50	20.52	45	254	203
	432	35.4		2	65	27.87			
	630	44		3.2	71	33.83	55		
10/8ST-AM	252	29	1400	2	50	26.08	45	254	203
	468	38		2	65	35.29	55		
	684	46.3		3.5	71	42.76	75		
10/8ST-AM	270	31.4	1485	2	50	31.91	55	254	203
	504	40.1		2	67	41.18	75		
	720	48.5		4	71	51.09	95		
10/8ST-AM	295.2	35	1540	2	50	40.20	75	254	203
	540	43.5		2.4	66	52.36			
	774	51.3		4.6	71	63.24	95		
10/8ST-AM	324	39	1580	2	50	51.12	95	254	203
	576	47.1		3	67	63			
	828	55		5.3	71	45 79.40	130		
10/8ST-AM	331.2	41.1	1600	2	50	56.1	90	254	203
	612	59.2		3	67	12.46	110		

AK ak kerkuar qe:
D. i jashtëm i cilindrit rr. Dc.j.=254mm;
D. i brendshëm i cilindrit rr. Db.c.=190mm
ndersa OE TE SAMIA ka ofruar keshtu:
Diamteri i jashtem(Outlet 203mm) dhe
Diametri i brendhsëm(Inlet 254).

Pozita nr.1

型号 Type	流量 Capacity Q(m³/h)	扬程 Head H(m)	转速 Speed n (r/min)	必需汽蚀余量 NPSHr(m)	效率 Eff η(%)	轴 S Pc P(
10/8ST-AM	234	26.1	1350	2	50	20
	432	35.4		2	65	27
	630	44		3.2	71	33

驱动形式/ Drive type

CR/CL传动 DC传动 CV传动

OE deklaron se pompat e ofruara iu
përmbahen kapaciteteve të ofruara
në Dosjen e Tenderit të kërkuara nga
AK.

渣浆泵尺寸

型号/Model	A	B	C
1.5/1B-AM	583	295	248
1.5/1C-AMH	759	406	311
2/1.5B-AM	592	295	248
3/2C-AM	768	364	311
3/2D-AMH	986	511	364
4/3C-AM	84	406	311
4/3D-AM	943	492	364
4/3E-AMH	1240	622	448
6/4D-AM	1021	492	364
6/4E-AM	1178	622	448
6/4F-AM	1456	857	635
8/6E-AM	1302	622	448
10/8ST-AM	1237	622	448
10/8F-AM	1635	990	635
12/10F-AM	1725	990	635
14/12F-AM	1755	990	635
16/14G-AM	2180	1208	876

- 25 -

Dimensionet nga
prodhuesi për
pompat me
parametrat 10/8

Edhe kapaciteti i dhënies është kërkuar të jetë Q=258m3/h ndërsa nga OE TE SAMIA SHPK është ofertuar me (270, 504 dhe 720) m3/h që tregon se nuk është në përputhshmëri me atë që është kërkuar nga autoriteti kontraktues e qe len për të nënkuptuar se edhe qarku punues dallon në diametër dhe gjerësi. Qarku punues dallon gjithashtu nga ai që është kërkuar edhe në prerjet e perajave (*shorrave*) të qarkut punues.

Në katalogun e ofruar nga OE TE SAMIA SHPK nuk është e cekur askund diametri qarkut punues që në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ishte kërkuar kështu: Diametri i qarkut punues të PP: Db=537mm. Edhe kjo gjithashtu konsiderohet mangësi.

Krejt këto mangësi dhe devijime në specifikimet teknike dhe në dëshmitë tjera të dorëzuara apo mos-dorëzuara nga OE TE SAMIA SHPK, e bëjnë këtë OE plotësisht të papërgjegjshëm ndërsa AK-në e bëjnë shkelëse të plotë të nenit 59 të LPP-së.

AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së edhe kur na ka cilësuar neve si të papërgjegjshëm me arsyetimin se e kemi prekur(*ndryshuar*) katalogun. Ky konstatim nuk qëndron fare sepse ne vetëm kemi bërë nënvizime dhe kemi shkruar në shqip sqarimin apo domethënien e atyre paqartësive që AK i ka pasur rreth pompave tona. Kjo nuk është ndërhyrje sepse ne nuk ia kemi fshirë apo ndryshua as edhe një të dhënë të vetme të katalogut të prodhuesit. Vlen të thuhet se ngjashëm sikur se ne, edhe OE që tani e ka shpallur fitues ka dhënë sqarime në katalogun e tij ndërsa AK nuk e ka sanksionua. Ja si duken ato që OE TE SAMIA ka shkruar në katalog:

Pra po shihet se edhe OE TE SAMIA ngjashëm sikur se ne ka dhënë sqarime por që AK nuk ia ka atribuua si mangësi apo ndryshim të katalogut. Kjo tregon se AK neve na ka diskriminua duke shpifur dhe aluduar se gjoja ne kemi bërë falsifikim në të dhëna. AK ka shkuar aq larg sa që edhe na ka kërcënuar duke na thënë se do të na fus në listën e zezë. Nisur nga kjo dhe pasi ia kemi komunikuar prodhuesit, jemi detyruar nga prodhuesi që OSHP-së të i ofrojmë prova dhe mundësi të verifikimit të të gjitha dëshmive që ne i kemi dorëzuar si në tender ashtu edhe gjatë sqarimeve. Ne kërkojmë nga OSHP që pasi të merr konfirmimin nga prodhuesi, të aplikoj masa ndëshkuese ndaj AK-së sipas dispozitave ligjore të përcaktuara për këtë qëllim përkatësisht të merr masa ndaj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për shpifje dhe mos respektim të kritereve të dosjes së tenderit si dhe aplikim të gabuar të LPP-së.

Ja sqarimi lidhur me atë që AK ka deklaruar për katalogun: Ne kemi dorëzuar një dokument që prodhuesi na e ka dërguar ku edhe e ka shënuar modelin e pompës që i përgjigjet qarkut të llojit të pompave Denver. Ai dukej kështu:

Model	Model	Photo	Flow m3/h	Head(M)	Pressure	DB	Out D.	inner D.	Power	rpm	Spec
10/8E-AH(R)	Slurry Pump		258	40.00	16bars	85mm	254mm	190mm	75KW/6	1485.00	380V , 50Hz 136A

AK e ka kontestuar shënimin e prodhuesit DENVER MODEL duke na akuzuar për falsifikim. Ne i kemi kërkuar prodhuesit deklaratë të veçantë për këtë qëllim dhe ja se si na përgjigjet prodhuesi:

HEBEI HUITONG PUMP CO.,LTD

ADD: NANYANG INDUSTRIAL ZONE OF ANGUO COUNTRY,BAODING CITY,HEBEI,CHINA.

Tel:86-312-3568337 Fax:86-312-3568765

Web:www.huitong-pump.com

We,Hebei Huitong Pump company mainly produce Slurry pumps,There are two main types of Slurry pumps we produce.

1.The slurry pump we produce has rubber internal parts (impeller, frame plate), which is improved on the basis of the Denver pump, improves the performance of the pump, and can replace the Denver model pump in use.

2.The slurry pump we produce has alloy internal parts (impeller, frame plate), which is improved on the basis of Warman pump, improves the performance of the pump, and can replace Warman model pump in use.

Hebei huitong Pump Co.,Ltd.

Signed by:

河北汇通泵业有限公司

Hebei Huitong Pump CO., LTD.

Pra me që kjo fabrikë prodhon qarqe punuese dhe pompa që u përshtaten dy llojeve të pompave, asaj DENVER dhe VARMAN, e ka pa të arsyeshme që ta jap atë informatë/shënim në skaj të këtij dokumenti grafik që na e ka dërguar për ofertim.

Përpos kësaj AK na ka akuzuar për falsifikim edhe kur kemi dërguar sqarime për pompat ku në katalogje e kemi shënuar në gjuhën shqipe sqarimin e nevojshëm për AK-në. Është e palogjikshme të akuzohemi në këtë formë kur dihet se prodhuesit kinez nuk vendos njoftime apo sqarime në gjuhën shqipe dhe nëse ne do dëshironim të dukej sikur atë e ka vendosur prodhuesi, atëherë do ta lenim në gjuhën angleze apo edhe kineze siç na e ka dërguar prodhuesi. Lidhur me këtë ne i kemi kërkuar prodhuesit që të japë një sqarim dhe ai na e ka dërguar dokumentin apo dëshminë e tillë edhe të vulosur në secilën faqe. Përpos kësaj na ka inkurajuar që instancave që merren ne ekspertimin e kësaj çështjeje të ua japim kontaktin e tyre që nëse kanë interes, ta bëjnë verifikimin e krejt kësaj që po akuzohemi. Ja si duket kërkesa e AK-së për sqarim dhe katalogu që e kemi dërguar si sqarim:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin tenderit të juaj si në vijim:

Pytja nr.1 **Bazuar në neni 59 të Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dh plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,si dhe nen 69,tek Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale si dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK,. Kërkojm sqarime shtesë për pjeset e pompave, sepse n katallogun tuaj nuk jan të specifikuara madhësit e pjesve të pompes si vijon:**

Diametri i boshtit të pernit të PP:Db=85mm;

Diametri i qarkut punues të PP: Db=537mm;

Diametri i jashtëm i cilindrit rr. Dc.j.=254mm;

Diametri i brendshëm i cilindrit rr. Db.c.=190mm

Të specifikohen këto pjesë në përputhje me aneksin nr.1 të dosjes së tenderit pra në madhësit e njëjta si me lartë.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh **me shkrim** në adresën lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e faks-it *[shëno numrin e faks-it]* apo n e-mailit *:trepcaprokurimi@yahoo.com*,deri me daten:**09.11.2023 ora:10:00h**

Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me,respekt,Ramiz Rama









Pra po shihet se kjo nuk është ndryshim e as falsifikim por është një sqarim lidhur me paqartësitë e AK-së dhe në asnjë formë nuk mund dhe nuk është e lejueshme të penalizohemi për diçka të tillë.

Ja se si na përgjigjet prodhuesi duke na e dërguar edhe një here katalogun me sqarimet e dhëna nga vet ata ku edhe e kanë vulosur. Për shkak të volumit të katalogut, ne po e paraqesim vetëm një foto ndërsa katalogun e plotë e gjeni tek dëshmia e bashkangjitur kësaj ankese:





As you can see on the picture and at the informations all parts are from the requested material (frame plate cirucuit impeller are from the rubber wich is anti-abrasive and reaction-resistant

河北汇通泵业有限公司
Hebei Huitong Pump CO., LTD.

AK ka shkuar edhe më larg sa që na e ka kontestuar edhe ISO certifikatën duke na akuzuar për falsifikim por nga ajo që na ka sqaruar prodhuesi shihet se AK nuk e ka kuptuar fare shënimin si "note" që ndodhet në certifikatë dhe atë e ka ngatërruar me afatin e validitetit të certifikatës. Ja si duket certifikata dhe "note" në bazë të cilës AK na akuzon neve:

Kaixin Certification (Beijing) Co.,Ltd.

Certificate of Registration

Registration No. : 626022E14207R0

This is to certify that

Hebei Huitong Pump Industry Co., LTD.

Unified Social Credit Code: 91130683667729959F

Address: Nanyang Industrial Zone, Anguo City, China.

The management system is in conformity with

GB/T24001-2016 / ISO14001:2015 standard

Scope: Production of Industrial Water Pump and Parts

Issue Date : *2022-04-15*
Term of Validity : *2025-04-14*

NOTE: The certified organization must accept the surveillance audit duly, and the audit shall be approved as effective before approving that this certificate can maintain as valid. On and by2023-04-16,this certificate shall be used together with notice of maintaining certification and registration.

Seal for Certificate
Issued by Ge Kai

ANAB
ANSI National Accreditation Board

MEMBER OF MULTILATERAL
IAF

Sipas asaj që thuhet tek kjo "NOTE" përkthehet kështu: "nga tani e deri më datën 16.04.2023 kjo certifikatë do të përdoret së bashku me njoftimin për renovimin e certifikimit dhe regjistrimit". Pavarësisht kësaj certifikata e tillë nuk ka qenë e kërkuar fare në tender por AK e ka ngatërruar. Kjo është certifikatë ISO 24001:2016 përkatësisht ISO14001:2015 ndërsa në tender ishte kërkuar vetëm certifikata ISO 9001/2015. Ne e kemi dorëzuar edhe certifikatën ISO 9001:2015 dhe e njëjta ka validitet deri në datën 17.08.2026. Certifikatën e tillë e gjeni të bashkangjitur kësaj ankese ndërsa më poshtë e gjeni edhe si foto:

CERTIFICATE OF REGISTRATION

凯新认证（北京）有限公司

质量管理体系认证证书

注册号： 626023Q10941R1

兹 证 明

河北汇通泵业有限公司

统一社会信用代码：91130683667729959F

地址：安国市南阳工业区

管理体系符合

GB/T19001-2016/ISO9001:2015 标准

认证覆盖范围

工业水泵及配件的生产

换 证 日 期 ：2023 年 08 月 28 日 — Data e rinovimit të certifikatës: 28 gusht 2023

证书有效期至 ：2026 年 08 月 17 日 — Certifikata është e vlefshme deri më: 17 gusht 2026

初 次 颁 证 日 ：2020 年 08 月 19 日 — Data fillestare e lëshimit të certifikatës: 19 gusht 2020

注 1：获证组织必须定期接受监督审核并经审核合格此证书方继续有效。自 2021 年 2 月 日起，本证书需与《保持认证注册资格通知书》一并使用。

注 2：本次再认证审核日期：2023 年 08 月 07 日至 2023 年 08 月 08 日

注 3：原证书到期日期：2023 年 08 月 18 日

ISO9001 KCB Certification

ANAB ANSI National Accreditation Board ACCREDITED ISO/IEC 17021 MANAGEMENT SYSTEMS CERTIFICATION BODY

MEMBER OF MULTILATERAL RECOGNITION ARRANGEMENT IAF

Pra kjo tregon se ISO certifikata është në rregull dhe se AK ka bërë shkelje të rëndë gjatë procesit të vlerësimit e sidomos gjatë kthimit të përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim kur na ka akuzuar për falsifikim duke na kërcënuar edhe se do të na fus në lista të zeza.

Për verifikimin e të gjitha dokumenteve të pranuara nga prodhuesi, ju mund të kontaktoni direkt prodhuesin në kontaktet e më poshtme:

Web faqja zyrtare: www.huitong-pump.com

Nr. i telefonit: +86 180 319 308 80

E-mail adresa: info@huitong-pump.com

Bazuar në krejt këtë që sqaruam më lartë, ne jemi tenderues komplet i përgjegjshëm dhe AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së kur na ka eliminuar me arsyetime të tilla të pabazuara.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar si duhet paragrafin 1.1 të këtij nenin gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Arsyeja pse mendojmë kështu është se si rezultat i mos vlerësimit si duhet sipas nenit 59 të LPP-së dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit, AK ka shpallur fitues një OE që posedon çmimin më të lartë se ne dhe që nuk është fare i përgjegjshëm. Kjo tregon se nga AK nuk është respektuar fare kriteri i vlerësimit të tenderëve. Sipas kësaj me plotë përgjegjësi konstatojmë se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk e ka aplikuar atë si duhet kriterin e vlerësimit të përcaktuar paraprakisht në dosjen e tenderit. Ligjërisht dhe realisht në rastin konkret, fitues do duhej mbeteshim ne ashtu siç kishte vepruar AK në fillim kur kishte publikuar Njoftimin e parë mbi Vendimin e AK-së.

5. AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së pasi që OE që e ka shpallur fitues nuk ka arritur të dëshmoj se është në përputhje me kërkesat e nenit në fjalë. Ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat e pikës 6.4 të FDT-së pasi që nuk ka sjellur dëshminë që tregon të shkuarën penale për kompaninë andaj konsiderojmë se është i papërgjegjshëm.

6. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar fare kriteret dhe kërkesat që vet i ka vendosur në përputhje me nenin 69 të LPP-së. Mungesa e dëshmive lidhur me plotësueshmërinë e specifikimeve teknike të dëshmuara me katalogun e dorëzuar nga OE i shpallur fitues tregojnë se OE nuk është i përgjegjshëm sipas kërkesave të FDT-së. Sipas kësaj ne konsiderojmë se me këtë veprim AK ka shkelur edhe vet nenin 69 të LPP-së. Mangësitë e këtij grupi i kemi paraqitur më lartë tek pika 3.

7. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që përkundër asaj që na ka kërkuar sqarime shtesë, nuk i ka respektuar dëshmitë e ofruara nga ne edhe pse ato ishim plotësisht në përputhje me ligjin dhe ofronin sqarimin që AK kishte kërkuar. Mos marrja parasysh e këtyre dëshmive dhe kontestimi i pabazuar i tyre, e shtynë AK-në në shkelje të plotë të nenit 72 të LPP-së.

Nisur nga krejt kjo që sqaruam më lart mendojmë se kemi elaboruar mjaftueshëm shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të prokurimit andaj kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtimit të pretendimeve tona të merr:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE "ROA Consulting SH.P.K. lidhur me tenderin

"Furnizim me pompa Denver dhe pjesë të pompës në Flotacion" i iniciuar nga Trepça SH.A..

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - Trepça SH.A. dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që besojmë se më pas do të duhej që Fitues të shpallej OE "ROA Consulting SH.P.K.".

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë - Kërkesa

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net. 2.Operatori ekonomik duhet të dorëzoj dëshmi lidhur me nenin 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nenparagrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4]. 3. Operatorit ekonomik duhet të deshmon se nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. [Neni 65 paragrafi 4, nënparagrafi 4.8].

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit Aneksi 2- kërkohet të dorzohet nga çdo ofertues me rastin e dorzimit të ofertëstenderit të tij. 2.Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit-duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues para Njoftimit te Tenderuesve, respektivisht dorëzimit te letrave standarde. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet]. 3.Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore-duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues para Njoftimit të Tenderuesve, respektivisht dorëzimit te letrave standarde. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet].

Kapaciteti teknik dhe professional - Kërkesa

1.OE duhet të specifikoj mallrat e ofruara në përputhshmëri me specifikat teknike të dosjes te tenderit,si dhe të ofroj katallogun e produkteve të ofruara ne perputhje specigfikimet përkatëse. 2.OE duhet të ofroj çertifikatën për cilesi sipas ISO standard 9001 nga prodhuesi. 2.OE duhet të ofroj çertifikatën për cilesi sipas ISO standard 9001 nga prodhuesi.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.OE duhet të perpiloi deklarate me shkrim dhe të vulosur, dhe të deklaron qartë se mallrat e ofruara jane ne përputhshmeri të plote me specifikim teknike të neksit nr.1 të dosjes se tenderit. Gjithashtu Koatallogi i ofruar të jetë i nenvizuarr për secilin pozicion sipas radhes. 2.Çertifikata valide ISO 9001 2015 .

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i ri-vleresimit konstaton se kemi pranuar tre tenderues te cilet dy oferta jane te pergjegjshem me kerkesat administrative, te pranueshmerisë, kerkesat profesionale dhe kerkesat teknike dhe ekonomke. Oferta e OE, "ROA Consulting" SHPK. nuk eshte e pergjegjshme nga aspekti teknik, katalogu dhe certifikatat ISO e dorezuara nuk janë në pajtueshmeri me aneksin 1 te dosjes së tenderit. Nuk ka sjell fare katalog apo fletë të katalogut, vetem ka tentuar disa pershkrime te modifikoj dhe nuk perputhen me katalogjet e prodhuesve. Prandaj Komisioni i vleresimit rekomandon qe me kontrat te shperblehet sipas kriterit per kontrat dhe dosje te tenderit: tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet e qe eshte oferta e OE, "TE SAMIA" SHPK. me çmimin total prej 83,072.00€.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ROA Consulting SH.P.K.**

Sqarim hyrës

Parashtruesi i ankesës – OE "ROA Consulting SH.P.K." (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 27.11.202, për të cilën AK me datë 01.12.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së pasi që edhe përkundër faktit që OE ankues ka plotësuar kërkesën që dokumentet e tenderit të mbesin si sekret afarist, AK i ka dhënë qasje OE të rekomanduar në dokumentet e OE akues.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti shqyrtues ka verifikuar se OE ankues në tenderin e tij ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist të nënshkruar dhe vulosur duke kërkuar që dëshmitë e dorëzuara nga OE ankues në lidhje me përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe professional me numër rendor 1 dhe 2 të trajtohet si secret afarist. Në lidhje me këtë kërkesë është dhënë arsyetimi s vijon: *Zbulimi i te dhenave nga oferta jone ndikon negativisht ne demtimin e biznesit tone duke no i keqperdorur te dhenat dhe informatat afariste per qellimet e tyre. Kjo na demton ne afarizmin e kompanise dhe lidhjet tona me prodhues te ndryshem.*

OE "Te Samia" me datë 09.11.2023 ka kërkuar përmes e-prokurimit ka kërkuar nga AK qasjenë ofertën e OE " Roa Conslting" me tekstin si vijon: "*Përshëndetje! Kërkojmë qasje në dokumente të OE të propozuar për kontratë për proceduren e prokurimit nr. ST 23 220 121 Ju lutem na dërgoni në formë elektronike (email) ofertën e OE të propozuar për kontratë*."

Në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga OE "Te Samia" me datë 12.11.2023, janë paraqitur pretendimet ankimore si vijon "*Komisioni i vlerësimit si duket nuk ka bërë vlerësim të ofertave fare, përshkrimet e ofruara nga OE i shpërblyer me kontratë nuk i ngjajnë as katalogut as ndonjë flete të katalogut. Vetem kamoflazh dhe tentim për mashtrim. Me ketë konsiderojmë se është në dëm të AK, sepse kur në këtë fazë nuk di se çka po vlerësohet e lëre më se çka do të*

liferojë OE, andaj këto praktika duhet të mos zbatohen. Në këtë rast AK ka dështuar që të hetojë se OE, ROA Consulting shpk ka falsifikuar katalogun e kërkuar për pozitën 1, 2 dhe 3. Në vazhdim ju paraqesim faktet:

Ne kemi arritur të kontaktojmë kompaninë Hebei Huitong Pump Industry Co.,LTD dhe të shfletojmë të gjitha katalogjet e tyre dhe nuk kemi gjetur pompën e ofertuar nga OE në fjalë. Në pamundësi të upload-imit të materialit në këtë platformë për shkak të madhësisë ne kemi bashkangjitur linkun për tek drive-i ku gjenden:

Foto 1. Foto e paraqitur në katalog nuk i përket prodhuesit Hebei Huitong Pump Industry Co.,LTD që gjendet në Kinë. Por i kompanisë FLSmidth nga Danimarka. Foto 2. Foto e paraqitur në katalog nuk i përket prodhuesit Hebei Huitong Pump Industry Co.,LTD. I përket kompanisë AmosTECH apo Shijiazhuang Gravel Slurry Pump Industry Co.,Ltd. Foto 3. Foto e paraqitur në katalog nuk i përket prodhuesit Hebei Huitong Pump Industry Co.,LTD. Por fotoja është marrë nga një broshurë prej kompanisë SMUKH ENGINEER. Foto 4. OE ka modifikuar foton duke i shtuar modelin Denver të cilin kompania Hebei Huitong. F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK Pump Industry Co.,LTD nuk e përmban në katalogje. Foto 5. Qarqet në katalogun e OE në fjalë nuk përputhen me ato tek specifikimet teknike në DT. Po ashtu nuk është ofruar asnjë pershkrim vetëm foto, nga ku nuk shihen as modele as të dhëna se për çfarë pompa mund të perdoren. Qarqet 1 & 2. Më poshtë gjenden linku për qarkun me pozitën 2 dhe pozitën 3 të cilat përputhen plotësishtë me specifikimet në DT"

Në lidhje me informatat sekrete afariste dhe detyrimet e AK-së neni 11 i LPP-së përcakton: *"1. Pa prejudikuar detyrimin për t'u siguruar palëve të interesuara dhe publikut qasje në shënimet e aktiviteteve të tij të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen. 3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere: 3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje*

me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji; 3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe 3.3kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik. 5. Nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, dhe prandaj ky autoritet kontraktues vendos që këtë dokument ta largoj nga materiali në të cilin palët e interesuara dhe anëtarët e publikut kanë të drejt qasjeje sipas paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin publiku ka qasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të përmbledhjes së tillë një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar të gjitha informacionet që gjendeshin në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesë të operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) se dokumenti i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe se është një përmbledhje e përgjithshme jo-sekrete e origjinalit."

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti fillimisht sqaron se OE " Roa Consalting" ka dorëzuar kërkesën tek AK konform nenit 11 të LPP-së për klasifikimin e informatave si sekret afarist duke plotësuar deklaratën dhe nënshkruar. Më tej bazuar në provat shkresore rezulton se OE "Te Samia" ka patur qasje në tërësi në katalogun e dorëzuar nga OE "Roa Consulting". Andaj, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 11 të LPP-së, paragrafi 1, 3 dhe 5. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së pasi që ka rekomanduar OE i cili nuk plotëson kërkesën e përshtatshmërisë të specifikuar në dosjen e tenderit.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2

AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat e përshtatshmërisë ka paraqitur kërkesën si vijon: "*1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net. 2. Operatori ekonomik duhet të dorëzoj dëshmi lidhur me nenin 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nenparagrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4]. 3. Operatorit ekonomik duhet të dëshmon se nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. [Neni 65 paragrafi 4, nënparagrafi 4.8].*" Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit Aneksi 2 - kërkohet të dorzohet nga çdo ofertues me rastin e dorzimit të ofertës tenderit të tij. 2. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit-duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues para Njoftimit te Tenderuesve, respektivisht dorëzimit te letrave standarde. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet]. 3. Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore- duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues*

para Njoftimit të Tenderuesve, respektivisht dorëzimit te letrave standarde. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet]."

OE në tenderin e tij ka dorëzuar:

1. Deklaratën në betim sipas formës standarde të nënshkruar nga z.Sami Lahu (Drejtor dhe Agjent i regjistruar sipas të dhënave në Agjencinë për Regjistrin e bizneseve) dhe vulosur me vulën e OE.

2. Vërtetimin tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës me numër serik 1001087112, në të cilin shënohet se Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore.

3. Certifikatë mbi dënimet penale të lëshuar me datë 27/10/2023 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në të cilën shënohet: Sami, Lahu, me nr. personal te identifikimit **********, i/e lindur me **.**.**** në Gllamnik i/e gjinisë Mashkull, nga i ati Sherif Lahu dhe e ëma Zethane Lahu Dema, Shtetas i Kosovës, nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë.

AK me datë 22.11.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin ku shpërblen me kontratë OE "Te Samia", përkatësisht i njofton dy OE-të me letrat standarde.

OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-së me datë 27.11.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim. Në kërkesë OE ka paraqitur pretendimin ankimor se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 65 të LPP-së duke shpërblyer me kontratë OE i cili nuk ka dorëzuar dështimtë e kërkuara në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë.

AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 30.11.2023 ka paraqitur arsyetimin në lidhje me këtë pretendim: "*Dokumentet e përshtatshmërisë pika 2 dhe 3 jane pranuar para se te ngarkohet B58 ashtu siç është cekur ne njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit.*"

Në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë, në nenin 45.31 të Rregullores për prokurimin publik thuhet: " *[..] Para se Raporti i vlerësimit të aprovohet, ZPP kërkon nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës dështimtë për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë të specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Pas pranimit të dështmive të pranueshmërisë, ZPP nënshkruan raportin e Vlerësimit dhe e ngarkon në platformë.*"

AK në raportin e vlerësimit të tenderëve, në pjesën përfundimtare nuk ka dhënë informatat nëse janë plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë para se të aprovohet raporti i vlerësimit.

Gjithashtu eksperti ka analizuar dokumentet në sistem në lidhje me këtë aktivitet dhe rezulton se përveç dështmive të dorëzuara me ofertë nga OE i rekomanduar nuk ka dështmi të tjera të përshtatshmërisë të ngarkuara në sistem.

<u>Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2</u>

Eksperti sqaron se bazuar në provat shkresore në dispozicion, OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar të gjitha dështimtë e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, që dështmojnë pranueshmerinë sipas nenit 65 të LPP-së. Përkatësisht, janë dorëzuar vetëm deklarata nën betim, vërtetimi i ATK-së dhe certifikata mbi dënimet penale për pronarin e kompanisë, por nuk janë dorëzuar dështimtë në lidhje me nenin 65, paragrafi 4, nenparagrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4.

Në një rrethanë të tillë, AK ka rekomanduar për kontratë, përkatësisht ka aprovuar raportin e vlerësimit të tenderëve dhe ka publikuar njoftimin mbi vendimin dhe letrat standarde pa u siguruar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit që lidhen me pranushmerinë e tenderuesve sipas nenit 65 të LPP-së, ashtu sikurse kërkohet me nenin 45.31 të Rregullores për

prokurimin publik. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme pretendim ankimor i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së pasi që ka rekomanduar OE i cili nuk plotëson specifikimet teknike të AK-së për shumë elemente të pompave.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 3

AK në njoftimin për kontraë dhe dosjen e tenderit ka përcaktuarkërkesën lidhur me kapaciteti teknik dhe professional: "*1.OE duhet të specifikoj mallrat e ofruara në përputhshmëri me specifikat teknike të dosjes te tenderit, si dhe të ofroj katallogun e produkteve të ofruara ne perputhje specifikimet përkatëse*." Dëshmia e kërkuar dokumentare në lidhje me këtë kërkesë është: "*1.OE duhet të perpiloi deklarate me shkrim dhe të vulosur, dhe të deklaron qartë se mallrat e ofruara jane ne përputhshmëri të plote me specifikim teknike të neksit nr.1 të dosjes se tenderit. Gjithashtu Koatallogi i ofruar të jetë i nenvizuarr për secilin pozicion sipas radhes."*

AK në aneksin 1 të dosjes së tenderit për pozicionin 1 ndër të tjera ka specifikuar, "Diametri i jashtëm i cilindrit rr. Dc.j.=254mm; Diametri i brendshëm i cilindrit rr. Db.c.=190mm, "*Diametri i boshtit të pernit të PP:Db=85mm*".

OE "Te Samia" ka dorëzuar dokumentin "Pjesë të katalogut për pompa" në të cilin janë paraqitur specifikimet e produktit të ofertuar. Në katalog është nënvizuar modeli që ofertohet me shifrën 10/8ST-AM.Në katalogun e dorëzuar, në faqe 3, janë paraqitur specifikimet e modelit të ofertuar si vijon: Inlet 254, Outlet 203. Ndërsa në faqën 6 të katalogut është nënvizuar nga OE dhe është vënë shënimi "Dimensionet nga Prodhuesi për pompat me parametrat 10/8". Në dimensionet e prezantuara tek pika U paraqitet vlera 80, ku në ndërlidhje me vizatimin rezulton se diametri i boshtit është 80mm.

Me datë 09.11.2023 OE "Te Samia" ka ngarkuar në platformë dokumentet shtesë në folderin e emërtuar "*Dokumenta shtesë të kërkara nga AK.zip*". Gjithsej janë dorëzuar 3 dokumente shtesë përfshihen "*Pjesë të katalogut për pompa.pdf*", "*Pjesë të katalogut për qarqe.pdf*" dhe "*Pjeset e kerkuara nga AK.jpg*".

Eksperti ka analizuar katalogun e dorëzuar me sqarimet shtesë, i cili është identik sikurse katalogu i dorëzuar me ofertë. Ndërsa dokumenti "*Pjeset e kerkuara nga AK.*" paraqet vizatimin teknik të produktit të ofertuar me shifrën e modelit 10/8 ST-AM ku janë parqitur disa dimensione si vijon: U-Dp=85mm, Diameter of the pin shaft of PP, F-Dw.c=537mm, Diameter of the working circuit of PP, M-Dc.o=254mm, The outer diameter of the cylinder, K-Dc.i =190mm, The inner diameter of the cylinder.

Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3

Eksperti sqaron se konform kërkesës së dosjes së tenderit, OE i rekomanduar ka dorëzuar katalogun e prodhuesit "An Pump" në të cilin është nënvizuar modeli që ofertohet 10/8ST-AM. Ashtu sikurse është sqaruar me lartë, specifikimet teknike të modelit të ofertuar dallojnë në 3 pikat e pretenduara. Përkatësisht dimensionet e prezantuara në katalogun e dorëzuar me ofertë janë të ndryshme me ato të specifikuara në aneksin 1 të dosjes së tenderit. Më tej, në sqarimet shtesë OE ka dorëzuar një vizatim të produktit të ofertuar të shoqëruara me vlerat për dimensioneve të kontestuara të cilat dallojnë nga vlerat e dimensioneve të paraqitura në katalogun e dorëzuara nga OE me ofertë. Eksperti sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim të nenit 59, paragrafi 2 i LPP-së ku thuhet "2. *AK mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen*

nga një tenderues." Kjo për faktin se dimensionet në dokumentin teknik të pranuar me sqarime dallojnë nga ato të prezantuara në katalogun e prodhuesit të dorëzuar me ofertë, dhe ky ndryshim përbën ndryshim material të dokumenteve të tenderit, të cilat nuk mund të pranohen dhe të merren si të mirëqena nga AK. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Pretendimi ankimor 4

OE ankues pretendon se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të dhëna nga AK.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 4

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka përcaktuar kërkesën lidhur me kapaciteti teknik dhe profesional: "*1.OE duhet të specifikoj mallrat e ofruara në përputhshmëri me specifikat teknike të dosjes te tenderit, si dhe të ofroj katalogun e produkteve të ofruara ne përputhje specifikimet përkatëse*." Dëshmia e kërkuar dokumentare në lidhje me këtë kërkesë është: "*1.OE duhet të përpiloi deklarate me shkrim dhe të vulosur, dhe të deklaron qartë se mallrat e ofruara janë ne përputhshmëri të plote me specifikim teknike të aneksit nr.1 të dosjes se tenderit. Gjithashtu Katalogu i ofruar të jetë i nënvizuar për secilin pozicion sipas radhës."*

OE ankues në tenderin e tij ka dorëzuar deklaratën për specifikimet teknike ku thekson se pajisjet e ofertuar janë konform specifikimeve të dosjes së tenderit. Gjithashtu, është dorëzuar dokumenti "*Katallogu i Pompes.pdf*" në të cilin shënohet Hebei Huitong Pump, është paraqitur imazhi i pompës dhe në kënd shënohet Denver Model. Në pjesën e poshtme në tabelë janë të dhënat e detajuara ku shënohet edhe modeli 10/8E-AH (R)- Slurry Pump. Më tej është paraqitur imazhi i pompës si dhe janë paraqitur karakteristikat tjera dhe dimensionet.

Me datë 06.11.2023, AK përmes letrës standarde ka kërkuar sqarime nga OE ankues me tekstin si vijon: *Për te vlerësuar tenderin e juaj ne mënyrë te duhur, ne kërkojmë qe te siguroni sqarimin e tenderit te juaj si ne vijim: Pyetja nr.l Bazuar ne neni 59 te Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,si dhe nenit 69,tek Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale si dhe UDHEZUES Nr.001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK,. Meqe ju keni ofruar përshkrimin teknik dhe një pjese te katalogut ku madhësitë e kërkuara teknike përputhen me ato te aneksit nr.1 te dosjes se tenderit, por nuk po mundemi me ditur qarte se pompat e ofruara i pershtaten radhitjes dhe linjes se vendosjes ti referohesh formes se pulegja(l + l)rrypat dhe mbrojtesit e tyre(gabaritit) ,si dhe pjesët e kërkuara janë te njëjta si ato ne specifikimin teknik te kerkuar ne kerkojm katallog shtese nga ju ? Ku te nenvizohet lloj i pompave te ofruara te gjitha te dhenat teknike, diagramin e pompave ku shifet pikeprerja, si dhe pjesët te pompave te nevizuara ne katallog? Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet te pranohen prej nesh me shkrim ne adresën e larte shënuar te autoritetit kontraktues ose ne numrin e faks-it [sheno_numrin e faks-:jt] apo ne e-mailit: trepcaprokurimi@yalzoo.com, deri me daten:09.11.2023 ora: 10:00h.*

OE ankues me datë 07.11.2023 ka ngarkuar dy dokumente. Dokumentin me emërtimin "*katalogun*" në të cilin janë paraqitur fotografi dhe vizatime teknike të pompës, qarqeve punuese, diagramin ku shifet pikeprerja, si dhe pjesët e pompave. OE ankues në dokument ka paraqitur përshkrimin tek pompa, pjesët dhe diagrami. Gjithashtu, është dorëzuar dokumenti me emërtimin "*sqarime per dimenzionet e pjesëve te pompes 07.11.2023*" në të cilin është paraqitur modeli i pompës dhe karaskteritikat tjera të njëjta me ato të paraqitura në dokumentin "*Katallogu i Pompes.pdf*" të dorëzuar nga OE me ofertë, si dhe është paraqitur shënimi Diametri i qarkut punues te PP:Db=537mm.

AK në letrën standarde për tenderuesin eliminuar të datës 22.11.2023, ka dhënë arsyetimin për eliminimin e OE ankues si vijon: "*Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ne ofertën e juaj, nuk*

keni dërguar fare katalog apo fletë te katalogut me përshkrime teknike te detajuara. Edhe pas dërgimit te letrës standarde te kërkesës për sqarim tenderi, ju keni sjell vetëm disa përshkrime te modifikuara nga ana juaj dhe asnjëra nuk është në pajtueshmëri të plotë me aneksin 1 te dosjes se tenderit dhe kërkesat e parashtruara ne njoftim për kontratë, kushtet për pjesëmarrje: neni Ill.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional dhe ne dosjen e tenderit."

OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-së me datë 27.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së duke e kundërshtuar arsyetimin për eliminim si vijon: "*AK ka bërë shkelje edhe kur na ka cilësuar neve si të papërgjegjshëm me arsyetimin se e kemi prekur - ndryshuar katalogun. Kjo nuk qëndron fare sepse ne vetem kemi bërë nënvizime dhe kemi shkruar në shqip domethënien e tyre apo paqartësive që AK i ka rreth pompave tona. Kjo nuk nënkupton ndërhyrje sepse ne nuk ia kemi fshirë apo ndryshua as edhe një të dhënë të vetme të katalogut të prodhuesit. Bazuar në këtë ne jemi tenderues komplet i përgjegjshëm dhe AK ka shkelur plotësisht nenin 59 kur na ka eliminuar me arsyetimin e till të pabazuar. Sipas kësaj po shihet se AK e ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së*"

AK me datë 30.11.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin si vijon: "*Ju nuk keni sjellur sqarime te detajuara edhe pas kërkesës për sqarim tenderi per asnjërin nga tre pozicionet e kërkuara ne aneksin l le dosjes se tenderit, ndërsa përshkrimet qe keni sjellur nuk janë ne pajtueshmëri me kërkesat e AK te cekura ne aneksin l te dosjes se tenderit. Komisioni profesional i caktuar për ri-vlerësimin e ofertave ka vlerësuar se ju keni qene me çmim me te ulet por fatkeqësisht kane konstatuar se përshkrimet e juaja teknik janë te pa përshtatshme nga aspekt i Teknik dhe profesional te cilat nuk do le ishin te përshtatshme me natyrën e punës e cila zhvillohet. Lidhur me këto përshkrime te produkteve, ju keni qene te pa qarte ne rastin me te mire, ndërsa ne rastin jo me te mire (keq) ju po tentoni qe te na mashtroni duke bere hamendesi me, ne përshkrimin e produkteve duke bere ndërhyrje te specifikacioneve ne katalogët e prodhuesve nga ato qe gjenden ne web faqen e tyre dhe duke marre foto nga me te ndryshme ne faqe dhe jo nga prodhuesi qe keni deklaruar me certifikatë ISO 9001 te prodhuesit, pm nuk janë te njëjta dhe te certifikata ISO 9001 keni bere nderhy1je ne data, pm nëse vërtetohet kjo ne instanca me larte si ne OSHP, ne sigurisht qe ta bëjmë kërkesën për futjen ne listën e zeze ne OSHP për falsifikimet e dokumenteve qe keni bere.*"

Në ankesën e dorëzuar në OSHP, OE ankues ka bashkangjitur shkresën HEBEI HUITONG PUMP CO.,LTD në të cilën shënohet: *Ne, kompania Hebei Huitong Pump prodhojmë kryesisht pompa Slurry, Ekzistojnë dy lloje kryesore të pompave Slurry që ne prodhojmë. 1.Pompa që prodhojmë ka pjesë të brendshme prej gome (helikë, pllakë kornizë), e cila është përmirësuar në bazë të pompës së Denverit, përmirëson performancën e pompës dhe mund të zëvendësojë pompën e modelit të Denverit në përdorim. 2.Pompa që prodhojmë ka pjesë të brendshme të aliazhit (helikë, pllakë kornizë), e cila është përmirësuar në bazë të pompës së Warman, përmirëson performancën e pompës dhe mund të zëvendësojë pompën e modelit Warman në përdorim*

<u>Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 4</u>

Eksperti fillimisht sqaron se në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka precizuar si arsye për eliminim vetëm pikën lidhur me katalogun, ndërsa në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK shton arsyet e eliminimit përkundër që të njëjtat nuk janë përmendur në vendimin e AK-së dhe letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ashtu sikurse kërkohet me nenin 54 të LPP-së, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 ku thuhet: "*në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat"*. Në një situatë të tillë, AK ka bërë shkelje procedurale për shkak se OE ankues i cenohet e drejta për paraqitjes të kërkesës për rishqyrtim pranë AK-së dhe pastaj ankimimit në OSHP ashtu sikurse precizohet me nenin 108/A. AK në vendimin e datës 30.11.2023 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, konstaton se në certifikatën ISO 9001 të prodhuesit Hebei Huitong Pump CO.,LTD, OE ankues ka bërë ndërhyrje në data. Megjithatë, në vendim më tutje AK thekson se "*nëse vërtetohet kjo ne instanca me larte si ne OSHP, ne sigurisht qe ta bëjmë kërkesën për futjen ne listën e zeze ne OSHP*

për falsifikimet e dokumenteve qe keni bere". Pra AK nuk ka bërë një kontroll efektiv të informatave për të ardh deri tek një konstatim i tillë. Eksperti ka verifikuar në faqen e prodhuesit Hebei Huitong Pump (http://en.huitong-pump.com/about.html#qualificationPage) ku është publikuar certifikata ISO 9001 e prodhuesit dhe në bazë të numrit të certifikatës që është i njëjtë me numrin e certifikatës të dorëzuar nga OE ankues, është bërë verifikimi në ueb faqen e trupës certifikuese e cila e ka lëshuar certifikatë.



Sipas verifikimit rezulton se certifikata ISO 9001 e prodhuesit Hebei Huitong Pump CO., LTD ka afat deri me datë 14.04.2025 e që është afati i njëjtë me afatin e skadimit në certifikatën e dorëzuar nga OE ankues. Rrjedhimisht, AK ka bërë vlerësim dhe konstatim të gabuar pa bërë verifikimet e nevojshme në lidhje me afatin e certifikatës.

Ndërsa në lidhje me arsyetimin e eliminimit, eksperti sqaron se në dokumentin e dorëzuar me ofertë nga OE ankues, me emrin "*katalogu*" nuk janë paraqit të gjitha specifikimet sikurse është kërkuar në kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit. Për këtë arsye me të drejtë AK ka kërkuar sqarimet shtesë. Në sqarimet shtesë të dorëzuar vërehet se OE ankues ka bashkangjitur pjesë të dokumenteve të prodhuesit dhe ka paraqitur edhe sqarime në gjuhën shqipe në lidhje me plotësimin e specifikimeve teknike të dosjes së tenderit. Arsyetimi i AK-së në letrën standarde për eliminimin e OE ankues fillimisht thekson "*nuk keni dërguar fare*

katalog apo fletë te katalogut me përshkrime teknike te detajuara. Edhe pas dërgimit te letrës standarde te kërkesës për sqarim tenderi, ju keni sjell vetëm disa përshkrime te modifikuara nga ana juaj dhe asnjëra nuk është në pajtueshmëri të plotë me aneksin 1 te dosjes se tenderit dhe kërkesat e parashtruara ne njoftim për kontratë, kushtet për pjesëmarrje: neni Ill.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional dhe ne dosjen e tenderit". Vlerësimi i AK nuk paraqet gjendjen reale pasi që OE ka dorëzuar dokumentin me modelin serik të pompës dhe informatat përcjellëse, ashtu sikurse konfirmohet në letrën standarde për sqarimin e tenderit të datës 06.11.2023 në të cilin theksohet "*Meqë ju keni ofruar përshkrimin teknik dhe një pjese te katalogut ku madhësitë e kërkuara teknike përputhen me ato te aneksit nr.1 te dosjes se tenderit, por nuk po mundemi me ditur qarte se pompat e ofruara i përshtaten radhitjes dhe linjës se vendosjes ti referohesh formës se pulegja (l + l)rrypat dhe mbrojtesit e tyre(gabaritit) ,si dhe pjesët e kërkuara janë te njëjta si ato ne specifikimin teknik te kerkuar ne kerkojm katallog shtese nga ju".* Pra në letrën standarde AK vlerëson se përshkrimi teknik i dorëzuar me ofertë përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit në anën tjetër në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar konstaton se përshkrimet e modifikuara nga OE ankues nuk janë në pajtueshmëri të plotë me aneksin 1 te dosjes se tenderit. Gjithashtu në arsyetimin ku AK thekson "*ju keni sjell vetëm disa përshkrime te modifikuara nga ana juaj*", eksperti sqaron se AK në kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit, ka kërkuar *"* [..] *OE duhet të ofroj katallogun e produkteve të ofruara ne perputhje specifikimet përkatëse"* që i bie se AK nuk ka kërkuar shprehimisht një katalog të prodhuesit apo nuk ka përcaktuar karakteristika se si do të duhej të ishte katalogu. Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se rekomandohet Paneli Shqyrtues që të obligojë AK-në që të bëjë rivlerësimin konform nenit 59 të LPP-së. Në rast se AK konsideron se janë të nevojshme të kërkojë informacione shtesë nga OE ankues, apo konform nenit 52, paragrafi 7 i LPP-së, të kryejë kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit përfshirë komunikimin me prodhuesin me qëllim të verifikimit të saktësisë së informatave dhe të vlerësojë plotësimin apo jo të specifikimeve teknike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Trepça SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ROA Consulting SH.P.K.**

Kreshnik Spahiu